

L I G J
Nr.7762, datë 25.10.1993

PËR KRIJIMIN DHE PRISHJEN E DISA MINISTRIVE

Në mbështetje të nenit 16, pika 13, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me kërkesë të Kryetarit të Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

Neni 1

I. Të prishen:

1. Ministria e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit me Jashtë
2. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë
3. Ministria e Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike

Neni 2

II. Të krijohen

1. Ministria e Industrisë dhe Tregtisë
2. Ministria e Financave
3. Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.683, datë 7.11.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.